



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1033 / prot.
3

Tiranë, më 23.07.2019

REKOMANDIM

Nr. 37, datë 23.07.2019

PËR KONTROLLUESIN "HERMES LINES"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Hermes Lines";

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 201, datë 28.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Hermes Lines" me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "Hermes Lines".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Hermes Lines" konstatoi se:

1. Kontrolluesi "Hermes Lines" operon në sektorin e transportit rrugor të pasagjerëve nga viti 2004 e në vijim. Kategoritë e subjekteve të cilëve iu përpunohen të dhënat personale janë "punëmarrës", dhe "klientë".
2. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: “...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të plotësojë kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.

3. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre. Për këtë arsye duhet të hartohet një rregullore e detajuar e cila të jetë e zbatueshme në praktikë dhe të reflektojë edhe masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.

4. Kontrolluesi ka nënshkruar deklaratat e konfidencialitetit me punonjësit, sipas parashikimit të nenit 28 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.06, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” të Komisionerit.
5. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave “klientë”, mbi përpunimin e të dhënave personale. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale,... Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

Detyrimi për informim duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që përfitojnë shërbime nga kontrolluesi, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin e konstatimit, më datë 10.07.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve.

Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh se procesi i punës së tij organizohet nga akte të tjera normative, subjektet informohen mbi të drejtat që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe deklaroi angazhimin maksimal për realizimin e konstatimeve.

Më datë 15.07.2019 kontrolluesi ka parashtruar pranë Zyrës së Komisionerit pretendimet me shkrim në lidhje me konstatimet e hetimit administrativ, ku ka dokumentuar:

- Plotësimin e Formularit të Njoftimit;
- Hartimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
- Hartimin e njoftimit informues mbi të dhënat personale të klientëve që përpunohen dhe të drejtat e tyre.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kontrolluesi “Hermes Lines” është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 18.07.2019 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë, ku ka argumentuar të njëjtat pretendime që ka paraqitur më parë në rrugë shkresore.

Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë faktin që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, bashkëpunimi i treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimi i menjëhershëm pas konstatimit të shkeljeve.

Në dokumentet e depozituara ku dokumentohet rikuperimi i shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij, konstatohet se rregullorja e brendshme e paraqitur është e përgjithshme dhe ka nevojë për t’u përmirësuar në disa nga elementët e përmbajtjes, duke u përshtatur në funksion të aktivitetit të kontrolluesit. Gjithashtu, konstatohet se Formulari i Njoftimit nuk është i përditësuar në disa rubrika si: “*të dhënat sensitive*”, “*qëllimet e përpunimit*”, “*transferimi ndërkombëtar i të dhënave*”.

Për rrjedhojë, Kontrolluesi duhet të mbajë parasysh përmirësimin e rregullores specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, si dhe të përditësojë Formularin e Njoftimit sa herë kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “Hermes Lines”, të përmirësojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat dhe aksesin në të dhëna, etj., në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 6/2012 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

2. Kontrolluesi "Hermes Lines", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me "qëllimet e përpunimit", "transferimi ndërkombëtar i të dhënave", etj.
3. Kontrolluesi "Hermes Lines", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda 30 ditëve nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23.07.2019

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

